

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Shërbimi ynë jo inteligjent"- Skandali i Vlora Hysenit, ish ministri i Brendshëm: Përgjegjësit aktrojnë me hipokrizi
ADRESA	https://piranjat.al/aktualitet/sherbimi-yne-jo-inteligjent-skandali-i-vlora-hysenit-ish-ministri-i-b-i105953
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 06:17:01 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 06:02:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	28f8b57eb39c3689154a11e532493a82f0f57049387b903da66b744e57eb83ec
TEKSTI	ca92349d0476f9a943fe9a84f774a6fdd7abca33ad02dcd99511929ce2100500
PAMJA	9742a593f5fa9e1adcdcd1437fd7f46b15b6426bc2d0a9173fe1c235bfbcb3693

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	702af4d112eefa44c9bfe87afc95f355edd934201345ef3ea3259e313b30f641
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b78e5a58bb99b6139c75653f203f708926b237e838138b6b7709d24a7b49499b
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/702af4d112eefa44c9bfe87afc95f355edd934201345ef3ea3259e313b30f641

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash:

ministri i
Brendshëm:
Përgjegjësit

përfshirë
ish
drejtuesen e

SOI

jugor ku
mëng...

nuk po
paguajnë;
Të ardhurat

më të
dobët në
buxhetin

dyert e
suksesit

caktoni se
cilat janë
përparësit...

Berisha:
Rama
dhe Vllora

ashpër pas
arrestimit të
ish-

AKTUALITET

“Shërbimi ynë jo inteligjent”- Skandali i Vlora Hysenit, ish ministri i Brendshëm: Përgjegjësit aktrojnë me hipokrizi

Piranjat Përditësimi i fundit 25 Shtator 2026, 08:02



Ish ministri i Brendshëm, Sandër Lleshi ka reaguar për skandalin që ka përfshirë ish drejtuesen e Shërbimit Informativ Shtetëror, Vlora Hyseni, e cila u la në masën arrest shtëpie për shkak të lidhjeve me Ergys Agasin.

Në një reagim në rrjete sociale, Lleshi argumenton se debati nuk duhet të përqendrohet te Hyseni, por te vetë shërbimi informativ dhe mënyra se si ai është ndërtuar e kontrolluar ndër vite.

Ai shpreh kritik teksa thotë se deputetët dhe drejtuesit politikë përgjegjës po aktrojnë me hipokrizi për ngjarjen, por shton se ata duhet t'u përgjigjen pyetjeve që kanë qytetarët.

Sipas Lleshit, ligji aktual për Shërbimin Informativ të Shtetit është i lidhur me dispozitat kushtetuese të vitit 1991 dhe, sipas tij, nuk përfaqëson një bazë të përshtatshme bashkëkohore për funksionimin e një shërbimi inteligjent në një shtet demokratik. Ai ngre pyetjen se përse ligjvënësit nuk kanë ndërhyrë për ta reformuar këtë kuadër ligjor gjatë dekadave të fundit.

“Përse përmes mosveprimit tuaj keni lejuar që ky shërbim informativ, që në fakt duhej të ishte një shërbim inteligjent, të funksionojë në bazë të një ligji qesharak që është më i vjetër se sa vetë Kushtetuta e Shqipërisë? Përse nuk kuptoni ende se, në këto rrethana, për gati tri dekada, praktikisht Shërbimi Informativ funksionon pa ligj?”

Përse nuk kuptoni ende se një shërbim që funksionon “de facto” pa ligj është një kërcënim potencial serioz për liritë dhe të drejtat e qytetarëve dhe për rrjedhojë edhe për sigurinë e vendit. Përse keni lejuar që Shërbimi Informativ të jetë strukturë me e pakontrolluar në Shqipëri, ndërkohë që strukturat homologe nga vendet e NATO-s dhe vendet e tjera demokratike janë më të kontrolluara ndër të gjitha institucionet e një shteti normal?”, thote ai.

“Fatin e ish-drejtueses së shërbimit tashmë e ka në dorë drejtësia”, shkruan Lleshi, ndërsa shton se “fatin e shërbimit informativ shtetëror dhe fatin e Shqipërisë” e kanë në një masë të konsiderueshme drejtuesit dhe përfaqësuesit politikë.

REAGIMI I PLOTE:

SHËRBIMI YNË JO INTELIGJENT

Vënia nën masë arresti e Drejttores së Shërbimit Informativ të Shtetit duket se i ka alarmuar të gjithë. Arrestimi është lajm i padëgjuar kurrë ndër ne e më përtej, ndërkohë që devijimet alarmate të këtij shërbimi nga ligji nuk kanë munguar përgjatë historisë tonë.

Është i mirëkuptueshëm dhe i ligjshëm zemërimi i qytetarëve të zakonshëm, që tashmë nuk dinë se kujt t'i besojnë më në këtë vend.

Por e papranueshme është maskarada e politikanëve dhe e deputetëve që nxitojnë të lajnë duart apo të përbetohen për ndershmëri, moral apo integritet, ndërkohë që kanë fjetur gjumë (në rastin më të mirë) për gati tri dekada rënuese për vetë shërbimin informativ.

Diskutimi publik për ish-drejtuesen e shërbimit tashmë nuk ka asnjë vlerë, përpos devijimit të diskutimit në detaje banale romantike.

Tërmeti katastrofik i ndodhur duhet të shërbejë për të DISKUTUAR RRETH SHËRBIMIT DHE JO RRETH DREJTUESES së pafat të tij.

Drejtuesit politikë përgjegjës dhe deputetët, që aktojnë sot plot hipokrizi për dramën, duhet të pyesin vetën dhe t'i përgjigjen popullit shqiptar për disa pyetje të rëndësishme:

A e dini se ligji në fuqi për Shërbimin Informativ të Shtetit është i bazuar në Dispozitat Kushtetuese të vitit 1991, pra jo në ndonjë kushtetutë, por dispozitat provizore që tepruan si rrënojë nga Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë të vitit 1976?!

A e dini se cili parlament i ka miratuar këto dispozita?!

A ju vjen turp për këtë?!

Përse përmes mosveprimit tuaj keni lejuar që ky shërbim informativ, që në fakt duhej të ishte një shërbim inteligjent, të funksionojë në bazë të një ligji qesharak që është më i vjetër se sa vetë Kushtetuta e Shqipërisë?

Përse nuk kuptoni ende se, në këto rrethana, për gati tri dekada, praktikisht Shërbimi Informativ funksionon pa ligj?

Përse nuk kuptoni ende se një shërbim që funksionon “de facto” pa ligj është një kërcënim potencial serioz për liritë dhe të drejtat e qytetarëve dhe për rrjedhojë edhe për sigurinë e vendit.

Përse keni lejuar që Shërbimi Informativ të jetë struktura më e pakontrolluar në Shqipëri, ndërkohë që strukturat homologe nga vendet e NATO-s dhe vendet e tjera demokratike janë më të kontrolluarat ndër të gjitha institucionet e një shteti normal?

Sigurisht që sot shtrohen edhe shumë pyetje të tjera, por ato të mësipërmet janë më të parat dhe me urgjentet.

FATIN E ISH-DREJTUESES SË SHËRBIMIT TASHMË E KA NË DORË DREJTËSIA, POR FATIN E SHËRBIMIT INFORMATIV SHTETËROR DHE FATIN E SHQIPËRISË E KANË NË DORË NË NËJË MASË TË KONSIDERUESHME DREJTUESIT DHE PËRFAQËSUESIT POLITIKË TË SAJ.

Ndërperja e menjëhershme e dëmëve të pallogaritshme që shërbimi dhe vendi kanë pësuar nga kjo gjëmë, që ende po ndodh, si dhe marrja e masave për ndërtimin e një shërbimi të mirëfilltë inteligjent të bazuar në parime, përvoja dhe standarde demokratike dhe perendimore është sot një detyrë emergjente kombëtare.

Nëse nuk arrini të kuptoni këtë gjë, apo nëse përtëni të merreni me të për shkak të miliona ‘prioriteteve’ të tjera që ndiqni, të paktën bëni një akt minimal formal: ndryshoni datën e miratimit të ligjit, sepse është më shumë se turp që Ligji për Shërbimin Informativ të Shtetit të jetë më i vjetër se sa vetë Kushtetuta e Shtetit.

Në vend të që qani apo të shkulin flokët përpara kamerave për dramën, kujtohuni se ky shërbim, me të njëjtin ligj si sot, i solli dëme kolosale vendit në vitin e tmerrshëm 1997.

Por sot nuk mundet më që përsëri të gjithë të rendin pas gurit të radhës që është hedhur në lumë.

Askush nuk mund të pranojë më se problemi i vërtetë është një drejtuese e papërshtatshme.

Jo dhe jo!

Problemi i vërtetë është se kemi një shërbim informativ fantazëm dhe shumë më tepër se kaq.

Artikuj te sugjeruar

AKTUALITET 25 Shtator07:59

[Sigurimet drejt rregullave të reja, kapital sipas rrezikut dhe mbrojtje më e fortë për konsumatorët](#)

Kërkesat për kapital të shoqërive të sigurimit do të bazohen në profilin e rrezikut të veprimitarisë së tyre,...

AKTUALITET 25 Shtator07:45

[Rikthehen reshjet e shiut, parashikimi i motit për sot](#)

Kthjellimet mbeten dominante gjatë gjithë ditës në të gjithë Shqipërinë, përjashtuar ekstremin jugor ku mëng...

AKTUALITET 25 Shtator07:35

[Bizneset po kërkojnë dhe po marrin më shumë kredi](#)

Kërkesa për kredi në sektorin bankar u rrit ndjeshëm në gjysmën e parë të këtij viti, ndërsa paralelisht edhe...

AKTUALITET 25 Shtator07:17

[Shqetësimet e bankave, rritet perceptimi i rrezikut nga tregu i pronave dhe ai politik](#)

Rezultatet e vërtetimit mbi perceptimin e rreziqeve sistemike në vend nga sektori bankar tregojnë se, gjatë gjysmës së parë të...

AKTUALITET 25 Shtator07:04

[Rikthimi i penaliteteve, bizneset nuk po fitojnë, apo nuk po paguajnë; Të ardhurat bien 5%](#)

Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin janë zëri me ecurinë më të dobët në buxhetin e shtetit në tetë muajt e pa...

AKTUALITET 24 Shtator23:35

[Prova që fundosi shefin e Policisë Shkencore, dërgoi akt-ekspertimin e makinës që rrëmbeu biznesmenin!](#)

Një akt-ekspertimi për makinën “Land Rover Defender”, i kryer me kërkesë të SPAK nga Policia Shkencore, ka mbërit...

AKTUALITET 24 Shtator22:35

[Artan Hoxha tregon prapaskenat se si arriti Ergys Agasi të përdorte Kadastrën e AKSHI-n: Ja si u bë miliarder](#)

Gazetari Artan Hoxha ka komentuar zhvillimet e fundit rreth ish-drejtores së SHISH, Vlora Hyseni dhe Ergys Agasit, duke pretenduar se çështja n...

AKTUALITET 24 Shtator22:24

[“Ka treguar papjekuri”, avokati për çështjen “Hyseni”: Të hetohet në SPAK për shpërdorim detyre](#)

Avokati Idajet Beqiri ka kritikuar SPAK në “Real Story” për mënyrën e veprimit ndaj dosies së Ergys Agasit dhe lidhjen me i...

AKTUALITET 24 Shtator22:22

"Do plasë skandali te Kadastra", Peka: Këshilli i Rregullimit të Territorit është bastisur nga SPAK

Ish-zëvendësministri i Brendshëm, Avenir Peka, ka paralajmëruar zhvillime të reja hetimore në lidhje me Kadastrën dhe Kë...

AKTUALITET 24 Shtator22:09

Sherr mes Lalës dhe Rexhajt: Meriton të rrihesh siç të rrihte Buzhala, por s'i ndyj duart me ty

Një përplasje e ashpër ka ndodhur në studion e "Opinion" mes analistit Albatros Rexhaj dhe gazetares Klodiana Lala. Debatu u nd...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 24 Shtator

EMRAT/ 63-vjeçari i intubuar te Trauma. Çfarë n...

Një ngjarje e rëndë e ndodhur më 16 shtator në Sarandë, e cila nuk ishte bërë publike më herët, ka përfun...

AKTUALITET 24 Shtator

Atentati ndaj vëllait të Fabio Dushkut/ Aksioni...

Policia greke ka zhvilluar një aksion në Selanik, ku ka arrestuar tre shtetas shqiptarë të dyshuar për përfshirje në një&eum...

AKTUALITET 24 Shtator

EMRI/ Ra në gropën e ashensorit dhe vdiq, si u ...

Altin Kokici, një 51-vjeçar me origjinë shqiptare, është gjetur i vdekur natën mes të mërkurës dhe të enjtes...

Nga Xhuljan Ferzaj INVESTIGIME 23 Shtator11:40

EKSKLUZIVE/ Eskortat e huaja "mbysin" Tiranën: Si vajzat nga Brazili, Kolumbia e Vietnami ofrojnë shërbime sek*uale për 50-150 euro

Prostitucioni me shtetase të huaja po shfaqet gjithnjë e më hapur në disa prej qyteteve kryesore të Shqipërisë. Përmes...

video



PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1



PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1





“Dua 120 mijë euro”/ Si u zaptua prona në rrugën e Durrësit, zbardhet skema e mashtrimit



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.